

2012



100 Vjet Pavarësi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Ministria e Financave

Raporti fiskal mujor

Janar – Maj, 2012

TABELA E PËRMBAJTJES

TREGUESIT FISKALË PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012	2
ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012	2
Vështrim i përgjithshëm	2
Të ardhurat sipas taksave, tatimeve dhe burimeve të tjera	4
Taksimi i konsumit (indirekt)	4
Taksimi direkt	6
ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012	7
Vështrim i Përgjithshëm	7
Shpenzimet Korrente	8
Shpenzimet e Personelit.....	9
Shpenzimet për Interesa	10
Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes	10
Shpenzimet për Subvencione.....	11
Shpenzimet për Fonde Speciale	11
Shpenzime të Pushtetit Lokal.....	12
Ndihma Sociale.....	12
Shpenzimet Kapitale	13

TREGUESIT FISKALË PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012

Nga të dhënat e Thesarit të Ministrisë së Financave, për 5mujorin e parë të 2012s, të ardhurat totale në buxhetin e konsoliduar arritën në 132.7 miliardë lekë. Të ardhurat totale buxhetore ishin 6.2 përqind më të ulta së parashikimi dhe 2.0 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet totale arritën në 151.8 miliardë lekë, 3.2 përqind më të larta së planifikimi dhe 0.8 përqind më të larta se një vit më parë. Shpenzimet korrente janë rritur mbi baza vjetore me 2.6 përqind, ndërsa shpenzimet kapitale kanë rënë me -13.9 përqind.

Defiçiti fiskal, i llogaritur si diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjithsej të buxhetit të konsoliduar, arriti në këtë 5mujor në -19.1 miliardë lekë, 13 miliardë lekë më shumë se planifikimi, dhe 1,321 milionë më i ulët se e njëjta periudhë e një viti më parë. Defiçiti është financuar në pjesën më të madhe me burime të brëndshme (kryesisht huamarrje): 607 milionë lekë janë të ardhurat nga privatizimi të destinuara për financimin e defiçitit; 13.6 miliardë lekë të ardhurat nga huamarrja e brëndshme neto. Financimi i huaj neto i defiçitit ka qënë në nivelin 7 miliardë lekë, ose 2.8 miliarde më shume se planifikimi.

Treguesit kryesorë të buxhetit të konsoliduar për periudhën janar-maj

Milionë lekë	Janar - Maj '11	Planifikimi Janar - Maj '12	Janar - Maj '12
TË ARDHURAT TOTALE	130,121	141,494	132,717
SHPENZIMET TOTALE <i>nga te cilat:</i>	150,548	147,104	151,823
SHPENZIMET KORRENTE	122,129	122,394	125,342
SHPENZIMET KAPITALE	28,419	21,500	24,481
BALANCA FISKALE	-20,427	-5,610	-19,106
BALANCA PRIMARE	-5,335	12,355	-2,804

ANALIZA E TË ARDHURAVE PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012**VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM**

Të ardhurat e buxhetit të konsoliduar për periudhën 5-mujore arritën në 132.7 miliardë lekë, 6.7 perqind me pak se parashikimi per 5 mujorin e vitit vitin 2012 dhe 1.5 perqind me shume se nje vit me pare duke shenuar rritjen me te ulet ne pese vitet e fundit me perjashtim te 5 mujorit te vitit 2011 ku rritja ishte 1.1 perqind.

EMËRTIMI	5M-2007	5M-2008	5M-2009	5M-2010	5M-2011	5M-2012
TOTALI TE ARDHURAVE (mln lekë)	93,235	111,542	120,397	128,744	130,121	132,717
Rritja vjetore	7.5	19.6	7.9	6.9	1.1	2.0

Të ardhurat nga tatimet dhe

doganat u realizuan në masën 93.6 përqind ndaj parashikimit, ose rreth -6.2 miliardë lekë me pak nga afersisht 97.2 miliardë lekë të planifikuara per periudhen, dhe 1.7 përqind me shume se 5-mujori i nje viti me pare; të ardhurat nga pushteti vendor arritën në 5.8 miliardë lekë nga 7 miliardë lekë të planifikuara per 2012 (17.3% me pak) dhe me renie vjetore prej -8.1 përqind; të ardhurat në fondet speciale arritën 24.6 miliardë lekë nga rreth 24.3 miliardë lekë të planifikuara, me rritje 1.5 përqind me shume se plani dhe 4.7 përqind me shume se e njejta periudhe e nje viti me pare; te ardhurat nga ndihmat rezultojnë për periudhën 751 milion lekë nga rreth 865 milionë lekë të një viti më parë; të ardhurat jo-tatimore kanë qenë për këtë periudhe 9.9 miliardë lekë nga 9.93 miliardë të një viti më parë, me renie vjetore -0.3 përqind dhe realizim te planit prej 107.6 përqind.

Pesha specifike e çdo tatimi në totalin e të ardhurave tatimore

		5 – MUJORI	
		STRUKTURA	
EMERTIMI		2011	2012
II.	TË ARDHURAT TATIMORE GJITHSEJ	100.0%	100.0%
II.1	Nga Tatimet dhe Doganat	75.0%	74.9%
1	T.V.SH.	37.0%	37.2%
2	Akciza	8.4%	6.3%
3	Tatimi mbi Fitimin	11.2%	11.2%
4	Të Ardhura Personale	9.4%	9.1%
5	Taksat Nacionale dhe tjera	6.7%	9.3%
6	Taksa e Doganore	2.3%	1.9%
II.2	Të ardhurat nga Pushteti Vendor	5.3%	4.7%
II.3	Të ardhurat nga Fondet Speciale	19.7%	20.3%

Sipas agjencie te mbledhjes, administrata doganore ka mbledhur 47.2 miliarde leke, -3.4 përqind me pak se parashikimi per vitin 2012, dhe me rritje 4.7 përqind kundrejt 5-mujorit te vitit 2011. Sipas zerave te te ardhurave qe mbledhin doganat, bie ne sy performanca e rentes minerare ne eksport, qe eshte rritur mbi baza vjetore me rreth 79.2 përqind, kryesisht si pasoje e rritjes se eksporteve te burimeve natyrore si dhe ndryshimeve ne normen e

taksimit dhe ne strukturen e taksës. Te ardhurat nga akciza ne dogane rezultojne me renie prej -9.4 përqind kundrejt planit

Të ardhurat në Dogana sipas muajve dhe krahasimi me 2011

Dogana total 5mujori I 2012	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2011
Janar	7,700	-47.1	-4.7
Shkurt	8,779	14.0	8.4
Mars	10,861	23.7	13.1
Prill	9,446	-13.0	0.8
Maj	10,408	10.2	5.0

dhe me nje rritje prej 0.7 përqind ne krahasim me nje vit me pare. Te ardhurat nga TVSH ne import jane 4.3 përqind me te larta se nje vit me pare dhe -3.2 përqind me pak se parashikimi per periudhen 5 mujore.

Administrata tatimore ka mbledhur 0.4 perqind me shume te ardhura se 5-mujori i vitit 2011 ose

Tatime Total 2012	Muaji (milionë lekë)	Në % ndaj muajit paraardhës	Në % ndaj 2011
Janar	14,071	-6.5	1.1
Shkurt	12,016	-14.6	2.6
Mars	14,128	17.6	-2.1
Prill	13251.8	-6.2	4.8
Maj	12566.6	-5.2	-3.8

261 milion leke me shume (perfshire dhe kontributet). Totali i te ardhurave tatimore ka pasur nje renie prej -1.6 perqind krahasuar me te njejten periudhe te nje viti me pare dhe nje mosrealizim te planit ne masen - 9.5 perqind, ndersa te ardhurat nga kontributet jane rritur me 4.5 perqind mbi baza vjetore.

Administrata tatimore ka rezultate te mira vetem ne mbledhjen e taksave nacionale dhe te akcizes per kete periudhe krahasuar me nje vit me pare dhe perkatesisht me 33.7 perqind dhe 1.6 perqind, ndersa TVSH ka pasur nje renie prej -4.4 % ne krahasim me te njejten periudhe te nje viti me pare; Tatim Fitimi ka pasur nje renie prej -23.1 % ne krahasim me te njejten periudhe te nje viti me pare; Tatim mbi te Ardhurat personale ka pasur nje renie prej -2.4 % ne krahasim me te njejten periudhe te nje viti me pare.

TË ARDHURAT SIPAS TAKSAVE, TATIMEVE DHE BURIMEVE TË TJERA

TAKSIMI I KONSUMIT (INDIREKT)

Nga TVSH jane mbledhur gjithsej per 5-mujorin 45.16 miliarde leke, ose 2.2 perqind me shume se nje vit me pare dhe -6.6 perqind me pak se parashikimi per vitin 2012.

Tatimi mbi vlerën e shtuar 5Mujori në vite

EMERTIMI	2009	2010	2011	2012
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (milion leke)	42,422	41,846	44,175	45,162
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Total (rritja vjetore ne %)	(14.7)	(1.4)	5.6	2.2
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (milion leke)	29,133	32,531	33,674	35,124
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Dogana (rritja vjetore ne %)	(16.2)	11.7	3.5	4.3
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (milion leke)	13,289	9,315	10,501	10,038
Tatimi mbi Vleren e Shtuar Tatime (rritja vjetore ne %)	(11.2)	(29.9)	12.7	(4.4)

Nga Administrata Doganore janë mbledhur 35.1 miliardë lekë TVSH mbi mallrat e importuar, duke realizuar planin e periudhës ne masen 96.8 perqind. Per kete periudhe, të ardhurat nga TVSH-ja në doganë përbëjnë rreth 77.8 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja. Ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar ato rezultojnë te jene 1.45 miliardë lekë më shumë ose 4.3 përqind me shume. Per muajin Maj TVSH ne dogane ka nje mos realizim prej 1.15 miliarde leke me pak ose 3.2 perqind me pak se parashikimi per periudhen.

Të ardhurat nga TVSH në doganë ndikohen direkt nga vlera e importeve (volumet e importuara, çmimet në import dhe kursi i kembimit).

Nga administrata tatimore për periudhën Janar – Maj janë mbledhur 10 miliardë lekë TVSH nga 12.1 miliardë lekë të planifikuara, që do të thotë -17 përqind më pak se parashikimi dhe -4.4 përqind më pak se një vit më parë. Për këto periudhe, të ardhurat nga TVSH-ja në tatime përbëjnë rreth 22.2 përqind të të ardhurave gjithsej nga TVSH-ja.

Rimbursimi i TVSH-se për periudhën 5-mujore nga tatimet dhe doganat ka arritur shifrën 2.6 miliardë leke nga 2.7 miliardë që ishte një vit më parë, me një ulje prej -3.3 përqind, sikurse pasqyrohet në tabelën në vijim.

Milionë lekë	2010	2011	2012	Në % ndaj 2011
TVSH e arkëtuar (bruto)	44,030	46,850	47,763	1.9
TVSH neto	41,846	44,175	45,162	2.2
Rimbursimi faktik i paguar	2,184	2,675	2,601	(2.8)

Në strukturën e të ardhurave tatimore që mbledhin tatimet, vihet re renia e peshës specifike të TVSH-se ndaj totalit, nga 24.6 përqind në 5 mujorin 2011 në 22.2 përqind për 5-mujorin 2012:

Akciza

Të ardhurat gjithsej nga Akciza për periudhën Janar –Maj arritën në rreth 13.5 miliardë lekë; ose -9.6 % më pak se parashikimi sipas planit; krahasuar me të njëjten periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo takse janë rritur në masën 1.1 përqind.

Të ardhurat nga akciza që mbledhin Doganat ka një rritje prej 0.7 përqind kundrejt një viti më parë dhe -9.4 përqind më pak se parashikimi për periudhën Janar-Maj. Doganat mbledhin akcizën e karburantit të importuar dhe të birrës së importuar, si dhe të mallrave të tjerë që nuk taksohen me anë të pullës së akcizës (sic janë mallrat që i janë shtuar listës së mallrave të akcizës). Sipas llojit të mallrave kryesore me akcizë, situata e zhdoganimeve për periudhën ka qënë si vijon:

- Sasia e karburanteve të zhdoganuara për periudhën Janar – Maj 2012 është 140 mijë ton, me rritje vjetore prej 8 përqind.
- Sasia e cigareve të zhdoganuara për periudhën Janar – Maj 2012 është 1,418 ton, me rritje vjetore prej 40 përqind.
- Sasia e birrës së zhdoganuar për periudhën Janar – Maj 2012 është 11.1 milionë litra, me një rritje në krahasim me vitin e valuar prej 15 përqind.
- Kafeja e zhdoganuar për periudhën Janar-Maj ka qënë 8 përqind më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë (3,004 ton).

Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta për periudhën 5-mujore në disa vite pasqyrohen në tabelën më poshtë.

Nga administrata tatimore janë mbledhur nga akciza rreth 6.1 miliardë lekë, me rritje vjetore 1.6 përqind dhe realizim të planit të rishikuar në masën 90.2 përqind. Tatimet mbledhin akcizën mbi

Të dhënat e zhdoganimeve të mallrave të forta 05Mujori në vite

	2009	2010	2011	2012
Karburantet (ton)	24,757	47,989	27,894	30,764
Ndryshimi në %		93.8	-41.9	10.3
Birre (000 litra)	3,623	2,899	3,160	1,273
Ndryshimi në %		-20.0	9.0	-59.7
Cigare (ton)	346	300	224	292
Ndryshimi në %		-13.2	-25.5	30.7
Kafe (ton)	729	531	636	648
Ndryshimi në %		-27.1	19.7	2.0

cigaret dhe pijet alkoolike përveç birrës, përmes pullës së akcizës, si dhe akcizën e karburantit të prodhuar në vënd (ARMO). Në tabelen në vijim pasqyrohen të dhënat e të ardhurave nga akciza në vite për 5-

mujorin dhe sipas agjencive të mbledhjes (dogane/tatime)

Të ardhurat nga akciza (05Mujori në vite)

	2009	2010	2011	2012
Akciza gjithsej (mld lekë)	12,236	14,016	13,390	13,542
Ndryshimi vjetor (%)		-18.1	14.5	-4.5
Dogane (mld lekë)	6,630	8,632	7,356	7,409
Tatime (mld lekë)	5,606	5,383	6,034	6,133

TAKSIMI DIREKT

Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale arritën në 11 miliardë lekë për periudhën janar-Maj, me rënie prej – 1.9 përqind në krahasim me 5-mujorin e një viti më parë dhe me realizim të planit për vitin 2012 në masën 94.9 përqind.

Tatimi mbi të ardhurat nga biznesi

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për 5-mujorin 2012 arritën në rreth 7.7 miliardë lekë nga 10 miliardë të mbledhura një vit më parë, me një rënie të ndjeshme prej -23.1 përqind me pak se viti 2011, dhe -27.2 % me pak se plani i periudhës Janar-Maj 2012.

Tatim fitimi 2012	Muaji (milione leke)	Ne % ndaj muajit paraardhes	Ne % ndaj 2011
Janar	1,011	-39.4	-22.4
Shkurt	1,059	4.7	-4.9
Mars	2,923	176.0	-26.4
Prill	1355	-53.6	2.7
Maj	1340	73.5	-41.5

Të ardhurat nga taksa vendore mbi biznesin e vogël arritën në 1.1 miliardë lekë, me renie vjetore prej 36.5 përqind dhe plani I periudhes eshte realizuar ne masen 72.4 perqind

Taksimi i pasurisë

Për qëllime analize, këtu përfshijmë tatimin mbi ndërtesat, mbi tokën bujqësore dhe taksën e kalimit të pasurisë së paluajtshme. Per 5-mujorin taksat mbi pasurine arrijne ne 1.4 miliardë leke nga 958 milion leke te parashikuara dhe 48 perqind me te larta se nje vit me pare.

Taksat nacionale

Të ardhurat nga taksat nacionale ne total për periudhën, janë 11.3 miliardë lekë nga 9 miliardë lekë të parashikuara për periudhën Janar - Maj. Duke e krahasuar me të njëjtën periudhe të një viti më parë, të ardhurat nga ky grup taksash ka pësuar një rritje prej 41.1 përqind kjo si pasoje e reformes fiskale te ndermarre per keto grup taksash ne vitin e kaluar.

Taksa doganore

Të ardhurat nga taksa doganore për periudhën Janar – Maj janë rreth 2.3 miliardë lekë, -13.6 perqind me pak se parashikimi; krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2011, të ardhurat nga kjo taksë janë ulur me 411 milionë lekë, ose -15.1 përqind.

Të ardhura të tjera nga pushteti vendor

Të ardhurat e mbledhura nga taksat vendore për periudhën Janar – Maj arritën në 5.8 miliardë lekë nga 7 miliardë lekë të planifikuara, ndërsa kundrejt 5-mujorit të vitit 2011 të ardhurat janë ulur me 509 milionë lekë (rreth -8.1 përqind). Taksat e tjera vendore (pa taksën e biznesit të vogel dhe taksat mbi pasurinë për të cilat folëm më lart) kanë mbledhur rreth 3.2 miliardë lekë nga 4.5 miliardë leke të parashikuara, ndersa krahasuar me te njejten periudhe me vitin e kaluar keto taksa kane pesuar nje renie prej -9.4 perqind.

Të ardhurat e fondeve speciale

Të ardhurat në fondet speciale për periudhën Janar – Maj 2012 arritën në 24.6 miliardë lekë, me një rritje prej 4.7 përqind kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë dhe 1.5 perqind me shume se parashikimi per periudhen. Ky grup të ardhurash përbën rreth 20.3 përqind të të ardhurave tatimore gjithsej për këtë periudhë me 0.6 pike rritje duke e krahasuar me peshen e te njejten periudhe vitin e kaluar. Nga totali i fondeve speciale, rreth 24 miliardë lekë janë kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 691 milion leke te ardhura per kompensimin ne vlere te pronareve.

Nga sigurimet shoqërore janë mbledhur 20.8 miliardë lekë, me rritje vjetore 0.9 perqind; nga sigurimet shëndetësore janë mbledhur 3.1 miliardë lekë, 50.7 përqind më shume se 5-mujori i një viti më parë..

ANALIZA E SHPENZIMEVE PËR PERIUDHËN JANAR – MAJ 2012


VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, në fund të muajit maj 2012, arritën në rreth 151.8 miliardë lekë, nga rreth 147.1 miliardë lekë të parashikuara për këtë periudhë, duke u realizuar

në rreth 103.2 përqind të parashikimit të periudhës ose me një tejkalim prej rreth 4.7 miliardë lekë.

Në analizën e shpenzimeve për periudhën janar- maj 2012 duhet mbajtur parasysh fakti se në realizimin faktik të tyre, janë përfshirë edhe shpenzimet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave dhe nga fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit.


- Fondi rezerve i Keshillit te Ministrave, i planifikuar per vitin 2012, ne 2.0 miliarde leke, deri ne fund te muajit maj, eshte ekzekutuar ne rreth 325.7 milione leke, nga te cilat rreth 34.1 milione leke per shpenzime personeli, rreth 265.7 milione leke per shpenzime te tjera korrente dhe rreth 26.0 milione leke per investime.
- Fondi i kontigjences per ruajtjen e deficitit, i planifikuar ne rreth 2.66 miliarde leke, deri ne fund te muajit maj 2012, eshte perdorur ne rreth 2.1 miliarde leke, nga te cilat 2 miliarde leke jane dhene ne formen e huase KESH-it dhe 99.6 milione leke ne formen e subvencionit, per kompensimin e vleres se taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimet, tek njesite e qeverisjes vendore.



Krahasuar me planin vjetor, këto shpenzime janë realizuar në rreth 38.3 përqind, ndërsa kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë, shpenzimet buxhetore rezultojnë rreth 1.3 miliardë lekë më shumë ose rreth 0.9 përqind më të larta. Ecuria e shpenzimeve buxhetore në shumë absolute si dhe ritmi i rritjes së tyre gjatë periudhës janar-maj, në disa vite, jepet në grafikun e mëposhtëm

SHPENZIMET KORRENTE

Shpenzimet korente në fund të muajit maj 2012, kanë arritur në rreth 127.5 miliardë lekë. Krahasuar me planin vjetor këto shpenzime janë realizuar në rreth 39.6 përqind, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, këto shpenzime rezultojnë rreth 5.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 4.3 përqind më shumë.



Shpenzimet e Personelit


Brenda shpenzimeve korente, shpenzimet e personelit, që përfaqësojnë rreth 22.1 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar- maj 2012, rezultojnë rreth 1.5 përqind mbi parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime në fund të muajit maj janë realizuar në rreth 39.7 përqind të tij, ndërkohë që krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë shpenzimet e personelit rezultojnë rreth 815 milionë lekë më të larta, ose rreth 3.0 përqind më shumë.

Shpenzimet për paga janë rreth 2.9 përqind më të larta se një vit më parë ose rreth 692 milionë lekë më shumë se një vit më parë, ndërkohë që shpenzimet për sigurimet shoqërore janë rreth 123 milionë lekë më shumë ose rreth 3.3 përqind më të larta, se një vit më parë. Keto dy grupe shpenzimesh janë realizuar respektivisht 2.1 përqind dhe 1.3 përqind mbi nivelin e parashikimit të periudhës, duke qenë në të njëjtën kohë përkatësisht shpenzimet për paga rreth 41.5 përqind e planifikimit vjetor dhe shpenzimet për sigurimet shoqërore në rreth 41.0 përqind e ketij planifikimi.




Shpenzimet për Interesa

Shpenzimet për interesa që përfaqësojnë rreth 12.8 përqind të totalit të shpenzimeve korente të realizuara gjatë periudhës janar- maj 2012, rezultojnë me një kursim kundrejt parashikimit të periudhës, prej rreth 1.7 miliardë lekë, rrjedhojë kjo e kursimit për rreth 1.2 miliardë lekë në interesat e brendëshme dhe rreth 506 milionë lekë në interesat e jashtme. Kundrejt planit vjetor interesat janë realizuar në rreth 32.9 përqind, ndërsa krahasuar me një vit më parë ato rezultojnë rreth 1.2 miliardë lekë më të larta ose rreth 8.0 përqind më shume. Ecuria e shpenzimeve për interesa gjatë periudhës janar- maj, në vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.




Shpenzimet Operative dhe të Mirëmbajtjes

Shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes gjatë periudhës janar- maj 2012 arritën në rreth 15.7 miliardë lekë, duke qënë rreth 5.0 miliardë lekë mbi nivelet e parashikuara. Ketu duhen mbajtur parasysh edhe përdorimet nga fondi rezerve i Keshillit të Ministrave dhe nga kontigjenca, të evidentuara me sipër. Në të njëjtën kohë ato rezultojnë në rreth 54.2 përqind të planit vjetor.



Shpenzimet për Subvencione


Shpenzimet për subvencione në fund të muajit maj 2012 arritën në rreth 503 milionë lekë ose rreth 86 milionë lekë më pak se parashikimi. Këtu duhet marrë parasysh edhe fakti i përmendur më sipër se rreth 99.6 milionë lekë janë dhënë me vendime të Këshillit të Ministrave, në formën e subvencionit, për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave, tek njësitë e qeverisjes vendore.



Shpenzimet për Fonde Speciale


Shpenzimet për fonde speciale gjatë periudhës janar- maj 2012 rezultojnë rreth 1.8 miliardë lekë më pak apo rreth 3.8 përqind nën nivelin e parashikimit të periudhës. Kundrejt planit vjetor shpenzimet për fondet speciale janë realizuar në nivelin 38.1 përqind, nga të cilat sigurimet shoqërore janë realizuar në rreth 38.8 përqind të planit vjetor, sigurimet shëndetësore në rreth 39.4 përqind dhe shpenzimet për kompensimin e pronarëve në rreth 11.1 përqind të këtij plani.

Krahasuar me një vit më parë shpenzimet për sigurimet shoqërore rezultojnë rreth 2.4 miliardë lekë më të larta ose rreth 7.9 përqind më shumë ndërsa shpenzimet për sigurimet shëndetësore rezultojnë rreth 795 milionë lekë më të larta, ose rreth 7.5 përqind më shumë. Shpenzimet per kompensimin e pronareve ne fund te muajit maj 2012 rezultojne rreth 411 milione leke nen parashikimin e periudhes. Krahasuar me nje vit me pare keto shpenzime rezultojne rreth 77.9 perqind me te ulta, ose rreth 705 milione leke me pak



Shpenzime të Pushtetit Lokal


Shpenzimet e pushtetit vendor zunë rreth 8.6 përqind të shpenzimeve korrente. Për periudhën janar- maj 2012 ato kanë arritur në rreth 10.9 miliardë lekë nga rreth 9.0 miliardë lekë të planifikuara për këtë periudhë të vitit 2012, duke rezultuar me një tejkalim për rreth 1.9 miliardë lekë ose rreth 21.3 përqind mbi parashikimin e periudhës. Kundrejt planit vjetor këto shpenzime kanë arritur në rreth 37.1 përqind të tij. Krahasuar me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë rreth 1.35 miliardë lekë më të ulta ose rreth 11.0 përqind më pak. Ecuria e shpenzimeve të pushtetit vendor për periudhën janar- maj për disa vite jepet nga grafiku i mëposhtëm.



Ndihma Sociale

Pagesa e papunësisë është realizuar në rreth 101.6 përqind të parashikimit të periudhës, duke qënë rreth 41.0 përqind e parashikimit vjetor dhe rreth 52 milione leke me shume ose 14.5 përqind me e larte se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.


Ndihma ekonomike gjatë periudhës janar- maj 2012 rezulton rreth 652 milionë lekë më shume ose rreth 9.5 përqind mbi parashikimin e periudhës, duke qënë në të njëjtën kohë rreth 44.3 përqind e planit vjetor. Kundrejt të njëjtës periudhë të një viti më parë ndihma ekonomike rezulton rreth 1.0 miliarde leke me shume ose rreth 15.4 përqind me e larte.



SHPENZIMET KAPITALE

Shpenzimet kapitale deri në fund të muajit maj 2012 janë realizuar në rreth 34.8 përqind të planit vjetor. Këtu duhet të mbahet parasysh se rreth 26 milionë lekë janë dhënë nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për investime. Brenda këtyre shpenzimeve, investimet me financim të brendshëm janë realizuar në masën 49.9 përqind, ndërkohë që investimet me financim të huaj janë realizuar në masën 25.0 përqind të parashikimit vjetor.

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar investimet e brendshme rezultojnë rreth 9.0 miliardë lekë më të ulta ose rreth 39.5 përqind më pak, ndërkohë që investimet me financim të huaj rezultojnë rreth 5.0 miliardë lekë më të larta ose rreth 90.8 përqind më shumë. Për rrjedhojë, investimet në total në fund të muajit maj 2012 janë rreth 13.9 përqind më të ulta ose rreth 3.9 miliardë lekë më pak se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Struktura e investimeve kapitale të realizuar gjatë periudhës janar-maj 2012 është rreth 56.5 përqind nga financimi i brendshëm dhe rreth 43.5 përqind nga financimi i huaj.

